

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrëfimi i ndjerë i Reshat Arbanës: Kur isha fëmijë më ndalonin të hyja në teatër, më pas zgjodha artin jo ushtrinë
ADRESA	https://www.balkanweb.com/rrefimi-i-ndjere-i-reshat-arbanes-kur-isha-femije-me-ndalonin-te-hyja-ne-teater-me-pas-zgjodha-artin-jo-ushtreine/
BURIMI	balkanweb.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:54:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	4 shtator 2026, 13:14:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 4 shtator 2026, 13:13:00 UTC → 4 shtator 2026, 13:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f802a419e779fefb5da5eb9bb7f40d9c62138d556fe22ec672bdc505277f5fe5
TEKSTI	82079549291c11c4a27a5247ea2bf580986fba19995c54fb3594106ae403ffcc
PAMJA	130af2b54a7d83cf524b73c98fc68110a2be83609458c4e0f8eee67c61b93037

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	de8aa0cdb9afa06f804d234555f9129eb9dbb99832e7d8f084783e6d6dd3ca85
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/de8aa0cdb9afa06f804d234555f9129eb9dbb99832e7d8f084783e6d6dd3ca85>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Fillimi > Kulture e re

Rrëfimi i ndjerë i Reshat Arbanës: Kur isha fëmijë më ndalonin të hyja në teatër, më pas zgjodha artin jo ushtrinë

04 Shtator, 2026 15:14



Madhësia e tekstit: - +

Fatmira Nikolli

Një mbrëmje emocionale me kujtime të gjurmëve të para, sukseseve të para e përulje për ata që ju dhanë dorën e parë. Mbrëmja hapëse e Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar, solli në skenë dhe nderoi emra të njohur të kinemasë që vlerësuan miqtë e dikurshëm të ekranit të madh dhe folën me ndjeshmëri për publikun. Aktori i njohur Reshat Arbana, tha se të bësh art në kohë të çmendura do guxim.

“Jam tepër i emocionuar. Kam dalë mijëra herë në skenë, por po e them si burrat, emocionet që kam ndjerë sonte, nuk i kam ndjerë ndonjëherë. Në këto kohë të çmendura që po jetojmë, ngjarje si kjo e sotmja janë me rëndësi të madhe shumë. E kisha vendosur veten në gjumë dhe thashë se e kisha mbyllur me dekoratat, çmimet e titujt. Por ja që, në kuadrin e ditëlindjes së 86-të, më akordohet një çmim që vërtet më ka emocionuar shumë”, tha Arbana.

Ndërkohë që nuk i fshehu emocionet, në dridhjen e zërit dhe mirënjohjen për sallën e ngritur në këmbë, Arbana, kujtoi kohët që do bëhej aktor dhe kishte drojë, duke pyetur veten se pse e meritoi gjithë këtë.

“Çfarë bëra unë që mora tërë këto çmime e medalje. Punova shumë. Më



Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT



Nuk ndalet aksioni qytetar! Protestuesit bllokojnë Rrugën e Elbasanit me kazanë mbeturinash. Shoqërohet “djali i pankartës”

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD

17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit nisin sërish marshimin drejt Kuvendit, ecin mes makinave

17 Shtator, 2026



Protestuesit “shkulin” gardhin metalik të Ministrisë së Brendshme, tentojnë të “çajnë” kordonin e policisë. Mbërrijnë “Shqiponjat”

17 Shtator, 2026



FOTO+VIDEO/ Tensionet para Ministrisë së Brendshme, protestuesit hedhin letra higjienike në drejtim të policisë. Një i shoqëruar

17 Shtator, 2026



LIVE- Qytetarët në çdo skaj të qendrës! Protestuesit marshojnë në sheshin Skënderbej, tensione në Bulevard

17 Shtator, 2026

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



është dashur diçka e vogël, siç thoshte Kadri Roshi, që ai e quante dhunti, por unë e quaj talent. E ka dhënë ai i madhi i artit dramatik, të tjerat ishin punë. Dhe vërtet që ishin punë. Unë kam pasur dëshirë të madhe të bëhesha aktor. Isha adoleshent dhe me një shokun tim shkonim çdo natë në teatër, por e kishim të ndaluar të hynim, se ishte një tabelë që na ndalonte ata që ishin nën 16-vjeç si të ishin vetëm, si të shoqëruar”, kujtoi ai, duke rrëfyer se e ka nisur karrierën me atë ankthin e madh nëse do të bëhej dot aktor. Asokohe, mes dilemave të rioshit, për të një shenjë nga Zoti, ishte hapja e shkollë së aktorëve. “Dhe thashë, sa të bëhem ushtar, po shkoj të jap prova, mbase fitoj dhe fitova”, shtoi ai. Ende me sytë nga ajo kohë, ai vlerësoi, kolegët e dikurshëm.

“Isha adoleshent dhe shihja çdo javë Hamletin e të madhit Naim Frashëri. Shihja Kadri Roshin në rolin e Ezopit. Shihja Lazër Filipin në rolin e Leninit dhe thoja, si ka mundësi, nuk do bëhem kurrë aktor”.

Kur Arbana filloi punë në Teatrin Kombëtar, në oborrin e tij, shkëlqenin yjet e skenës. Arbana e tregoi mirënjohje ndaj atyre që e ndihmuan, kur tha se “ruaj një dashuri e respekt të madh. Ja, ia dedikoj këtë çmim edhe atyre të dashurve dhe të mrekullueshmëve aktorë. Me ndihmën e këtyre njerëzve të mrekullueshëm, të këtyre aktorëve të mëdhenj, të vërejtjeve, sugjerimeve, përkrahjes, arrita të bëhesha një aktor që gëzoj respektin e popullit”.

Emra të njohur të filmit si Pirro Milkani, Xhevdet Feri u nderuan duke ftuar familjarët e tyre dhe duke nderuara veprën e lënë pas. Më pas në skenë u ngjit edhe aktorja Roza Anganosti, që mori dekoratë për punën e saj, një pjesë të së cilës, ajo ia kushtoi bashkëshortit të ndjerë, regjisorit Dhimitër Anganosti.

“Unë jam pioniere e artit që filloi në vitin 1952 dhe jam krenare për këtë. E kam nisur nga teatri “Migjeni” i Shkodrës. Një rrugë e gjatë artistike, me punë, emocione, sakrifica, por edhe kënaqësi të madhe. Është moment i vështirë për mua dhe fjalët mund të duken të varfra për atë që dua të shpreh dhe e ndjej tani. Doja që Dhimitrin ta kisha në

kran kete moment. Ky çmim eshte vieresim jo vetem per mua, por edhe per të. Për bashkëshortin tim, për bashkëpunëtorin tim, në një jetë të gjatë në të gjithë rrugëtimin tonë të ngushtë të jetës dhe të veprimtarisë tonë artistike, i cili më ka mbështetur, më ka ndihmuar dhe ka sakrifikuar bashkë me mua që të krijojmë artin e bukur dhe të mrekullueshëm të kinematografisë.

Anagnosti ka një vit që është në përjetësi, por la veprën si shkollë dhe përkushtimet e tij si pjesë të kinematografisë shqiptare, edukimin qytetar dhe mbështetjen e gjithanshme për këtë brez dhe për brezat e rinj.

Në karrierën time kam pasur fatin të punoj pothuaj me të gjithë regjisorët e Kinostudios, Erebara, Mitro, Hysen Hakani, Çashku, etj. T'i kujtojmë me duartrokite ata që nuk janë më", tha ajo.

Në natën e parë të Festivalit, ministri i Kulturës Blendi Gonxhja, tha se festivali nderon artin shqiptar.

"Ju keni keni një mision të rëndësishëm me artin e krijimin që bëni që shkon përtej çdo inteligjence artificiale. Ne sot nuk kthejmë vetëm një festival, por kthejmë një traditë. Duam të kemi një arkitekturë të re sa i takon industrisë kreative dhe kinemasë, në mënyrë që talentet e rinj të kenë mundësi më të mëdha dhe më të barabarta", tha ai.

Pas ceremonisë me nderime, fjalimeve nga Kryetari i QKK-së, Jonid Jorgji, drejtori i festivalit Ilir Butka dhe producentja Rafaela Rica, u shfaq filmi i regjisorit Gjergj Xhuvani, "Liqeni im", projekti i fundit i një prej emrave më të mirë të artit të 7-të.

© **BalkanWeb**

Për t'u bërë pjesë e grupit **"Balkanweb"** mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

TË NGJASHME

Tabaku: "Balluku" dhe "Kayo" s'janë të izoluar, parlamenti përdoret për të mbrojtur korrupsionin

17 Shtator, 2026

"Kushtetuesja do të vendosë për Kayo-n", Tabaku: Do të denoncojmë në institucionet ndërkombëtare. Hetim parlamentar si me "Inceneratorët"

17 Shtator, 2026

TË FUNDIT NGA KULTURE E RE

"Fytyrat e luftës" festivali për të drejtat e njeriut në Kuvend

Fatmira Nikolli | 16 Shtator, 2026

Filmi "Policia e Dialogut" tek Akademia e Sigurisë, Suedia: Metoda e përdorur nga policia ndikon protestat

15 Shtator, 2026

Një popull ne dy anët e kufirit, viktima e familje të ndara për 50 vjet

15 Shtator, 2026

Policia, mbrojtja, luftrat/ Nis Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut te "Marubi"

Fatmira Nikolli | 14 Shtator, 2026

Tinka Kurti puth Kupën e karrierës/
Filmi i Gentian Koçit, filmi më i mirë
i festivalit
Fatmira Nikolli | 14 Shtator, 2026

Besimi dhe përndjekja në Shkodër,
në një film në Festivalin e Venecias
Fatmira Nikolli | 13 Shtator, 2026

KATEGORIA VIDEO



Nuk ndalet aksioni qytetar!
Protestuesit bllokojnë Rrugën e
Elbasanit me kazanë mbeturinash.
Shoqërohet "djali i pankartës"
17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit përmbysin
kazanët e mbeturinave para selisë së
PD
17 Shtator, 2026



VIDEO/ Protestuesit nisin sërish
marshimin drejt Kuvendit, ecin mes
makinave
17 Shtator, 2026



Protestuesit "shkulin" gardhin
metalik te Ministria e Brendshme,
tentojnë të "çajnë" kordonin e
policisë. Mbërrijnë "Shqiponjat"
17 Shtator, 2026



FOTO+VIDEO/ Tensionet para
Ministrisë së Brendshme,
protestuesit hedhin letra higjienike
në drejtim të policisë. Një i
shoqëruar
17 Shtator, 2026



LIVE- Qytetarët në çdo skaj të
qendrës! Protestuesit marshojnë në
sheshin Skënderbej, tensione në
Bulevard
17 Shtator, 2026

BalkanWeb

FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

KONTAKT

Focus Media News shpk

NUIS/NIPT K21909002K

Privacy Policy

Contact

Email:

EMISIONE NEWS24

Autoktonet

Emisioni Vila 24

Fit Station

Kjo Javë

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Në shënjestër

News24 Fundjavë

Oponencë

Podcast

Sport News

Studio 24

Tak Fak

Vetting

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today

© 2026 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.